



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-099

Prishtinë, më 11 mars 2013, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 11 MARS 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Petar Miletqi, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani dhe Sasha Milosavleviq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga zyra e Presidentit: Amir Haradinaj dhe

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që pika 2.3 të hiqet nga rendi i ditës dhe këtë e miratoi Kryesia.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 4 mars 2013,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

* * *

Në fillim të mbledhjes, kryetarja e Grupit Parlamentar të KKR-së, Myzejene Selmani, e njoftoi Kryesinë e Kuvendit se në vizitën zyrtare të delegacionit të Kuvendit të Kosovës në Sllovaki nuk ishte i ftuar asnjë deputet nga radhët e GP të KKR-së.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 4 mars 2013

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 4 mars 2013.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi gjatë kësaj jave t'i mbajë dy mbledhje plenare dhe atë:

Mbledhja plenare më 14 mars 2013, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i amendamenteve 23 dhe 24 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të propozuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës,
4. Zgjedhja e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe për familjarët e tyre,

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë për Krahësim dhe Verifikim të Pronës,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për produkte medicinale dhe pajisje medicinale,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për blegtorinë,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ujërat e Kosovës,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës.

Mbledhja plenare më 15 mars 2013, me këtë:

Rend dite

1. Debat parlamentar lidhur me faturimin e shpenzimit të energjisë elektrike për muajin janar 2013, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës,
2. Debat parlamentar për rastin “Kiçina”, sipas kërkesës së deputetit Ramiz Lladrovci, i mbështetur nga deputetët nënshkrues.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

1. Kërkesa e kryeministrit të Kosovës, z. Hashim Thaçi, për të raportuar në Kuvend lidhur me takimin e tij të gjashtë me kryeministrin e Serbisë në Bruksel

Kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, Adem Grabovci, i propozoi Kryesisë që kërkesa e kryeministrit të Kosovës, z. Hashim Thaçi, për të raportuar në Kuvend lidhur me takimin e tij të gjashtë me kryeministrin e Serbisë në Bruksel të radhitet në rend dite për mbledhjen plenare që do t'i vazhdojë punimet më 12 mars 2013.

Kryesia konstatoi se për kërkesën e lartshënuar duhet të vendosë seanca.

2. Vendimi i Presidentes për kthimin e Ligjit për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor në rishqyrtim

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me vendimin e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa që ta shqyrtojë vendimin e Presidentes së Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjit për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor dhe Kuvendit t'i paraqesë raportin me rekomandime brenda dy javësh.

3. Shqyrtimi i propozim-Planit Strategjik të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për periudhën 2013-2018

Propozim-Plani Strategjik i Veprimit të Kuvendit të Kosovës për periudhën 2013-2018 u shty për mbledhjen e radhës së Kryesisë.

4. Kërkesa e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” për debat parlamentar lidhur me tjetërsimin e pronës publike dhe shoqërore gjatë periudhës 22 mars 1989 deri më qershor 1999

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Legjislacion që ta shqyrtojë kërkesën e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” për debat parlamentar lidhur me tjetërsimin e pronës publike dhe shoqërore gjatë periudhës 22 mars 1989 deri më 10 qershor 1999, si dhe të deklarohej për bazën ligjore të propozim-rezolutës.

5. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi për formimin e komisionit të lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohet nga grupet parlamentare që deri në seancën e radhës t’i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

2. Përbërja e Komisionit duhet të jetë: GP i PDK-së 2 anëtarë, GP i LDK-së 2 anëtarë, GP VV 1 anëtar, GP i AAK-së 1 anëtar, GP i KKR-së 1 anëtar, GP i SLS-së 1 anëtar dhe GP “6+” 1 anëtar.

6. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Bosnjë-Hercegovinë

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i anëtarëve të Komisionit për Integritet Evropian, Lutfi Haziri dhe Xhavit Haliti, si dhe Safet Beqiri, nga stafi mbështetës për të marrë pjesë në Konferencën e shtatë të komisioneve parlamentare të integriteteve evropiane të shteteve pjesëmarrëse në procesin e Stabilizim-Asocimit në Evropën Juglindore, e cila do të mbahet në Sarajevë, më 21-23 mars 2013.

2. Shpenzimet e akomodimit për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga organizatori - Asambleja Parlamentare e Bosnjë-Hercegovinës, ndërsa shpenzimet e udhëtimit, si dhe mëditjet shtesë mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

Të ndryshme:

Nënkryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, ngriti çështjen e shkrimeve në gazetat “Tribuna Shqiptare” dhe “Kosova Sot”, që kishin shkruar për shpenzimet e derivateve në Kuvendin e Kosovës. Në këto shkrime ishte përmendur emri i tij se ka shpenzuar deri në 2 700 litra. Këto shkrime, sipas z. Konjufca, nuk janë të sakta. Diskutimi i plotë i z. Konjufca është dhënë në transkript.

Për këtë çështje diskutuan: Jakup Krasniqi, Xhavit Haliti dhe Ardian Gjini, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Në fund, Kryesia e Kuvendit konstatoi që Zyra për Media dhe Marrëdhënie me Publikun duhet ta përgatisë një informacion të plotë mbi bazën e evidencës së Shërbimit të Transportit për shpenzimet e derivateve dhe të njëjtën ta publikojë në ueb-faqen e Kuvendit.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 10:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*